



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:362590

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06706740

C.nr.9190/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.K. me numër personal nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson me autorizim av. Y.G.K. nga Peja, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – M.F.P.T. – Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim i pensionit shtesë sipas shkallës së inflacionit, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore, me datën 14.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, dhe HEDHET POSHTË SI E PALEJUAR padia e paditësit Xh.K. me shenjë C.nr.9190/2024, e datës 12.12.2024, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – M.F.P.T. – Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kompensim i pensionit shtesë sipas shkallës së inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, pranë Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – M.F.P.T. – Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kompensim i pensionit shtesë sipas shkallës së inflacionit.

Kjo Gjykatë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, gjeti se çështja e cila është objekt i kontestit nuk përbën çështje gjyqësore, por e njëjta përfaqëson çështje administrative sipas Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, në nenin 24 është përcaktuar që paraparë që “*Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin*

e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve dhe beneficioneve të përcaktuara me këtë ligj.”. Tutje me nenin 16 par. 2 dhe 3 të këtij Ligji është përcaktuar se “2. Për realizimin e së drejtës në pension, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Zyrën Rajonale të Departamentit të Ministrisë për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe viktimat civile të luftës. 3. Për realizimin e së drejtave në beneficione tjera, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Ministrinë dhe institucionet tjera përkatëse.”

Në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, kjo Gjykatë vlerëson çështja e pensioneve është kompetencë e organeve administrative, përkatësisht e Departamentit përkatës për pensione i cili funksionon në kuadër të M.F.P.T. Së këndejmi, kërkesa e paditësit për mbrojtje gjyqësore sipas padisë nuk mund të realizohet në procedurë kontestimore, dhe as në procedurë të konfliktit administrativ, për faktin se lidhur me kontestin e natyrës së tillë, gjykatës i mungon kompetenca gjyqësore, për vendosje për çështjen e ngritur me padi.

Në këtë mënyrë, Gjykata vlerëson se janë plotësuar prezumimet procedurale që të veprohet në kuptim të dispozitës së nenit 18 par.2 të LPK-së, e cila përcakton që “Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur”. Lidhur me këtë, dispozita e nenit 391 pika a) përcakton: “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore”.

Nga të cekurat në kuptim të dispozitës së nenit 17, 18.1, 18.2, 19 dhe 391 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.9190/2024, datë 14.01.2025

Gj y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.